

BALLKANI NGA LUFTA E PARË BALLKANIKE NË FUND TË LUFTËS GREKO-TURKE (1912-1922)

Orjon Ago

Metin Venxha

**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli”**

Abstrakt

Ballkani për 10 vjet, 1912-1922 u përfshi në disa konflikte të mëdha që patën ndikim në rajon. Dy luftrat ballkanike shkatuan me mijëra të vrarë e të plagosur. Pasojat ekonomike ishin të jashtëzakonshme. Këto shkatërrime nuk i frenuan ballkanasit dhe as i trembën për t'u përfshirë në konflikte të reja. Një vit pas Luftës së Dytë Ballkanike, vendet e Ballkanit u përfshinë në atë që bashkëkohësit e quajtën Lufta e Madhe. Futja në luftë e shteteve të Ballkanit, u pa nga politikanët e këtyre vendeve si një mundësi për të realizuar ambicjet e tyre të vjetra. Pozicionimi i tyre nuk ishte vetëm produkt i vendimeve të Fuqive të Mëdha, por ishin dhe kalkulimet e liderëve politikë në funksion të asaj që ata kërkonin të arrinin në fund të luftës.

Këto luftra e ndryshuan Ballkanin nga pikëpamja gjeopolitike. Pas largimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani edhe Austro-Hungaria e mundur në fund të Luftës së Parë Botërore u shpërbë. Shtetet e Ballkanit aleatë të fitimtarëve përfituan dhe zgjeruan territorin e tyre. Humbësit paguan faturën. Etja e madhe për zgjerim në përmbushje të programeve nacionaliste bëri që lufta të vazhdonte dhe pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Greqia duke menduar se ky ishte momenti i duhur për të realizuar Megali Idenë ndërmori një aventurë në Azinë e Vogël, e cila pati pasoja për të.

Fjalë kyçe: Lufta, Ballkani, shtete, kufij, traktate.

THE BALKANS FROM THE FIRST BALKAN WAR TO THE END OF THE GRECO-TURKISH WAR (1912-1922)

Abstract

The Balkans for 10 years, 1912-1922, was involved in several conflicts that had an impact on the region. The two Balkan wars cost thousands of dead and wounded. The economic consequences were enormous. These destructions did not stop the Balkans nor did they scare them to get involved in new conflicts. A year after the Second Balkan War, the Balkan countries

were involved in what contemporaries called the Great War. The entry of the Balkan states into the war was seen by the politicians of these countries as an opportunity to realize their old ambitions. Their positioning was not only a product of the decisions of the Great Powers, but also the calculations of the political leaders in function of what they sought to achieve at the end of the war.

These wars changed the Balkans from a geopolitical point of view. After the departure of the Ottoman Empire from the Balkans, Austria-Hungary, defeated at the end of the First World War, also disintegrated. The Balkan states allied to the victors benefited and expanded their territory. Losers paid the bill. The great desire for expansion in fulfillment of nationalist programs made the war continue even after the end of the First World War. Greece, thinking that this was the right moment to realize the Megali Idea, undertook an adventure in Asia Minor which had consequences for it.

Keywords: War, Balkans, state, borders, treaties.

Hyrje

Në shekullin XIX, popujt e Ballkanit u përfshinë nga lëvizjet nacional revolucionare. Me radhë u formuan shtetet ballkanike duke filluar me Greqinë e cila fitoi pavarësinë më 1830, Serbinë, Malin e Zi dhe Rumaninë të cilave iu njoh pavarësia nga Kongresi i Berlinit, me Bullgarinë që fitoi autonominë po nga ky kongres, për të fituar pavarësinë e plotë në vitin 1908, ndërsa Shqipëria u krijua si një shtet i pavarur në vitet 1912-1913. Popujt ballkanas hasën në rezistencën e Perandorisë Osmane (më tej PO) për të mos lejuar shkëputjen e territoreve ballkanike, ndërkohë që Fuqitë e Mëdha me ndërhyrjet e tyre ndërtuan një hartë politike të Gadishullit të Ballkanit sipas interesave të tyre dhe jo një hartë politike në bazë të parimit të kombësisë. Monarkitë ballkanike, Greqia, Serbia, Mali i Zi, Rumania dhe Bullgaria shfaqën pretendimet e tyre territoriale tej kufijve të banuar nga kombësitë e tyre.

Në mesin e shek të XIX u hartuan dy programe nacionaliste “Megali Idea” dhe “Nacertania”, të cilat drejtuan politikën e jashtme të Greqisë dhe Serbisë në shek e XIX dhe XX. Këto programe të mirënjohura kërkonin bashkimin e njësisë kombëtare me njësinë politike. Problemi qëndronte në faktin se popullsitë serbe dhe greke ishin mjaft të shpërndara dhe të përziera me popullsitë e tjera në Ballkan. Arritja e qëllimit nuk mund të bëhej vetëm se me luftë dhe me aleancat e nevojshme. Traktati i Shën Stefanit u bë udhërrëfyesi i

politikës së jashtme të Bullgarisë. Në këtë mënyrë ambicjet e tre shteteve do të përplaseshin në Maqedoninë e pretenduar nga secili shtet. Edhe shtetet e tjera Rumania dhe Mali i Zi ishin mjaft ambiciozë dhe kërkonin zgjerim territorial. Kështu një rajon si Ballkani, me kaq shumë shtete që kërkonin zgjerim territorial, përbënte një vatër krizash.

Gjatë Kongresit të Berlinit, pretendimet territoriale të vendeve ballkanike ishin të ekzagjeruara dhe nuk përputheshin me kriterin etnik, por i përmbaheshin programeve nacionaliste të hartuara më parë.

Serbia synonte të zgjerohej në Kosovë e cila banohej në shumicën dërrmuese prej shqiptarëve. Për popullin serb ky territor ishte i mbushur me legjenda historike. Bullgaria donte që asaj ti konfirmoheshin tokat e dhëna nga Traktati i Shën Stefanit të cilat ajo i konsideronte si një e drejtë historike që i rridhte asaj nga pushtimet bullgare në Mesjetë. Mali i Zi synonte Shkodrën ndërkohë që Greqia kërkonte Kretën, Thesalinë, Maqedoninë Jugore dhe krejt Epirin deri në Vjosë. (Frashëri, 1997, p. 114) Traktati i Berlinit ishte një kompromis që nuk kënaqi askënd dhe tronditi më shumë situatën politike në Ballkan, por garantoj një paqe në Europë për një periudhë të shkurtër. (Glenny, 2000, p. 146) Pavarësisht vendimeve të Kongresit të Berlinit, shtetet ballkanike vazhduan të punonin në drejtim të realizimit të qëllimeve të tyre.

Para vitit 1912, shtetet ballkanike nuk kishin arritur një marrëveshje për të luftuar kundër PO, edhe pse ideja për bashkimin e shteteve ballkanike në një front të vetëm kundër (PO) kishte dale në pah dhe më parë, por ishte nuk konkretizuar një aleancë sepse pengohej nga patriotizmi fanatik që karakterizonte këto shtete të reja, por dhe përplasjet e interesave për të njëjtat territore në Ballkan. (Schevill, 2006, p. 382)

Në fund të shek XIX e në vazhdim u rritën përpjekjet për bashkëpunim midis vendeve të Ballkanit dhe u rishfaq parrulla e vjetër, "Ballkani ballkanasve". Gjatë kësaj periudhe deri në shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike në tetor të 1912, ushtritë e shteteve ballkanike pësuan transformime të mëdha duke u përfshirë në një proces militarizimi. Në 1885 parlamenti bullgar vendosi si detyrë kryesore krijimin e një ushtrie masive dhe moderne. Qeveria bullgare filloi të blinte sasi të madhe artilerie nga firmat franceze dhe gjermane. Shumica e blerjeve financoheshin nga hua, të dhëna nga Fuqitë e Mëdha. (Glenny, 2000) Të njëjtën politikë ndiqnin edhe shtetet e tjera

ballkanike duke shpenzuar shuma të mëdha nga buxhetet e tyre për shpenzime ushtarake.

Pas krijimit të Aleancës Ballkanike, shtetet e Ballkanit donin që ta fillonin menjëherë luftën, por Fuqitë e Mëdha i druhashin luftës e cila do t'ju sillte në këtë periudhë paqeje më tepër humbje sesa përfitime. Antanta, që ndihmoi në krijimin e aleancës ishte kundër zhvillimit të shpejtë të luftës pasi kërkonte që potencialin ushtarak të vendeve ballkanike ta shfrytëzonte kur të kishte ballafaqim të drejtpërdrejtë me Bllokun Qëndror. Kësisoj, Fuqitë e Mëdha i bënë një deklaratë shteteve të Ballkanit ta ndalonin luftën. Kjo nuk u pranua nga Aleanca Ballkanike e cila ishte përgatitur për luftë. (Glenny, 2000, pp. 228-229)

1. Luftat Ballkanike dhe pasojat e tyre për Ballkanin

Lufta kundër PO, prej Bullgarisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë kishte si qëllim largimin e saj nga gadishulli dhe çlirimin e popujve të shtypur ballkanas. Por që në të vërtetë këtu qëndronte kleçka. Traktati i fshehtë i marsit 1912 mbi aleancën mbrojtëse dhe sulmuese, parashikonte që në rast fitoreje, territoret e pushtuara të ndaheshin midis fituesve. (Schurman, 2006, p. 73) Pra, nuk do të kishte çlirim por ripushtim dhe zëvendësimi i pushtimit osman në një pushtim tjetër sepse në këto territore shumica e popullsisë ishte shqiptare, me përjashtim të Maqedonisë ku kishte një popullsi të përzierë.

Lufta e Parë Ballkanike nisi në 8 tetor 1912, kur Mali i Zi i shpalli luftë PO. Ajo zgjati gjashtë javë. Luftimet u zhvilluan në një sipërfaqe prej afro 170 000 km², që nga bregdeti shqiptar në perëndim, deri 32 kilometra larg Stambollit në lindje; nga kufiri më verior i Maqedonisë deri në Thesali në Greqinë Qëndrore. Forcat osmane u detyruan të luftonin në katër fronte të ndryshme, kundër bullgarëve në Thrakë, serbëve dhe grekëve në Maqedoni, serbëve dhe malazezëve në Shqipërinë Veriore e në Kosovë dhe grekëve në Shqipërinë Jugore. (Glenny, 2000, p. 229)

Lufta ballkanike duhet të përfundonte pas Konferencës së Londrës në janar të 1913, mirëpo, humbja e ushtrisë turke e rindezi luftën e brendshme në Stamboll ndërmjet liberalëve dhe Komitetit për Bashkim dhe Përparim. Turqit nën trysinë e Fuqive të Mëdha kishin lëshuar Andrinopojën në 22 janar, me premtimin që ata të ruanin varret e sulltanëve në xhaminë e Selimit II. Të pakënaqur për këtë vendim,

nxënësit e shkollave fetare dolën në demonstrata me parullën: “*Më mirë vdekur, se paqe me turp*”. Në 3 shkurt, luftimet filluan në Adrianopojë-përgjatë vijës Çatallxha dhe gadishullin e Galipolit në det dhe tokë. (Glenny, 2000, p. 146) Qyteti i Adrinopojës ra në duart e aleatëve në 26 mars 1913, pas pesë muajsh.

Pasi aleatët ballkanikë kishin mundur PO, lindën kontraditat për ndarjen e plaçkës së luftës. Bullgaria mbajti peshën kryesore në luftë dhe pretendimi i saj kryesor ishte Maqedonia, e cila ishte pushtuar nga serbët dhe grekët. Në këto rrethana, kërkesa e Bullgarisë ishte që aleatët t’i lëshonin tokat që ajo synonte, por kjo u kundërshtua nga aleatët. Kjo çoi në zbehjen e marrëveshjeve të mëparshme dhe nisën konflikte të armatosura mes bullgarëve dhe serbëve. Serbët dhe grekët filluan të bënin bisedime të fshehta për të mos lejuar futjen e bullgarëve mes tyre në Maqedoni. (Schevill, 2006, p. 386)

Çështja e ndarjes së Maqedonisë u vendos më 30 maj 1913, kur u nënshkrua Traktati i Paqes i Londrës. Traktati ishte shprehje e vullnetit të Fuqive të Mëdha. Sipas traktatit, të gjitha tokat në perëndim të vijës Mida-Enos, me përjashtim të Shqipërisë, i kalonin aleatëve të Ballkanit. Shqipëria cunqohej dhe gjysma e territoreve të banuara me shumicë shqiptare iu dhanë Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi. (Schevill, 2006, p. 382)

Konferenca e Londrës ngjalli pakënaqësi, Greqia edhe pse zgjeroi territorin e saj dhe pothuajse e dyfishoi numrin e popullsisë, vazhdonte që të këmbëngulte për pjesën jugore të shtetit shqiptar. Bullgaria edhe pse fitoi territore përsëri mbeti e pakënaqur. Këtë pakënaqësi e ktheu në një ndjenjë revanshi, duke pritur që të realizonte aspiratat e saj nacionaliste. Serbia ishte zgjeruar drejt jugut duke marrë pothuajse të gjithë Vilajetin e Kosovës dhe pjesën veriore të Maqedonisë. Gjithashtu kishte mbështetur edhe Malin e Zi për të zgjeruar territoret, në Shqipërinë Veriore dhe nëpërmjet tij të siguronte një dalje në Detin Adriatik. (Bashkurti, 2014, p. 7)

Më 1 qershor 1913, u lidh aleanca Serbi-Greqi për të luftuar kundër Bullgarisë. Në marrëveshje përcaktohej dhe fati i Shqipërisë i cili do të ndahej midis dy shteteve, tokat në veri të Shkumbinit i jepeshin Serbisë dhe në jug Greqisë. Në këtë acarim të marrëdhënieve, Mali i Zi mbajti anën e Serbisë dhe Greqisë. Rumania e cila nuk mori pjesë në luftë, tashmë hyri në lojë dhe mori anën e Serbisë e të Greqisë, pasi kishte pretendime për Dobrukhën Jugore të cilën e kishte

Bullgaria. PO donte të përfitonte nga kjo armiqësi për të marrë tokat përtej vijës Midia-Enos. (Schevill, 2006, p. 386)

Më 28 qershor 1913, do të fillonte dhe Lufta e Dytë Ballkanike e nxitur nga lakmia. Greqia dhe Serbia vendosën të sulmojnë Bullgarinë në çastin e dobësisë të saj më të madhe. Por dhe Bullgaria nga ana e saj kishte filluar përgatitjet për luftë. Ajo u kishte dhënë urdhër trupave të saj të sulmonin drejt Maqedonisë dhe Serbisë. Pavarësisht ndërhyrjes së Rusisë dhe pëlqimit që kishin dhënë palët për të mbajtur bisedime nën kryesinë e car Nikollës më 29 qershor 1913 filloi Lufta e Dytë Ballkanike. (Glenny, 2000, p. 246) Lufta e Dytë Ballkanike zgjati një muaj dhe fshatarët e Maqedonisë vuajtën pasojat. Bullgaria pësoi humbje sepse kundër saj nuk ishin vetëm aleatët ballkanikë, Serbia, Greqia, Mal i Zi por dhe Rumania dhe PO.

Në pamundësi të Bullgarisë për të vazhduar luftimet, filluan bisedimet për paqe në Bukuresht. Sipas klauzolave të Traktatit të Bukureshtit, të përfunduar në mesin e gushtit 1913, Bullgaria u detyrua të dorëzojë thuajse të gjitha territoret, për të cilat dhjetëra mijëra qytetarë të saj kishin flijuar jetën. Adrinopoja u bë Edrene, duke u kthyer në duart e turqve pas tre muajsh. Rumunët kishin pushtuar Dobrukhën Jugore. Maqedonia u nda në tri pjesë të pabarabarta: Greqisë, i kaloi Maqedonia e Egjeut 50%, Bullgaria mori Maqedoninë e Pindit 10% ndërsa Serbia Maqedoninë e Vardarit që përbënte 40% të territorit. (Lory, 2007, p. 58) Ky traktat e la Bullgarinë të zemëruar e të grabitur nga ato që mendonte se i përkisnin. Përsa kohë qëndronte Traktati i Bukureshtit, çdo paqe në Ballkan ishte e pamundur. Shtetet e pakënaqura nga përfundim i luftimeve ballkanike, Bullgaria dhe PO të nxitura nga hakmarrja, do të bashkoheshin me cilindo bllok që plotësonte interesat e tyre territoriale. (Lory, 2007, pp. 247-248)

Pasojat e luftimeve ishin të mëdha, ku përveç ndryshimeve territoriale sidomos në dëm të Shqipërisë dhe Maqedonisë, kishte humbje të mëdha në aspektin njerëzor. Në dhjetë javë luftime, u vranë rreth 200 000 luftëtarë pa llogaritur civilët. Përveç tyre, dhjetra mijëra ranë viktime të kolerës, tifos dhe dizanterisë. (Glenny, 2000, p. 229) Lufta shkatërroi ekonomikisht popujt dhe solli rritjen e varësisë së vendeve të Ballkanit prej Fuqive të Mëdha, ndaj të cilave kishin marrë borxhe të shumta. Përsa i'u përket shqiptarëve, statusi i tyre u ngrit nga autonomia në pavarësi por me një territor të cunguar sepse ishin lënë jashtë Shqipërisë, Kosova, Çamëria, trevat shqiptare në Maqedonisë

perëndimore dhe trevat shqiptare në Mal të Zi.

Greqia megjithëse ishte zgjeruar territorialisht në përfundim të luftrave ballkanike nuk kishte hequr dorë nga pretendimet territoriale në drejtim të territoreve jugore të Shqipërisë. Diplomacia dhe forcat ushtarake greke u hodhën në veprim. Duke ndjerë edhe qëndrimin përgjithësisht dashamirës të Fuqive Europiane, ajo deklaronte se do të largohej nga Shqipëria e Jugut vetëm pas rezultateve të një plebishiti. (Dushku, 2012, pp. 193-194)

2. Pozicionimi i shteteve ballkanike gjatë Luftës së Parë Botërore

Mosmarrëveshjet dhe pakënaqësitë e luftrave ballkanike do ti hidhnin vendet e Ballkanit në gjirin e Fuqive të Mëdha, me shpresën për të realizuar aspiratat e lëna përgjysëm nga koha e luftrave ballkanike. Ballkani ishte rajoni prej nga ku nisi flaka e konflikti botëror. Më 28 qeshor 1914 në Sarajeve u vra duka Franc Ferdinand trashëgimtar i fronit austro-hungarez. Pas vrasjes së tij, Austro-Hungaria i vendosi një ultimatum Serbisë. Ultimatumit ishte parashikuar që të refuzohej, por qeveria serbe u përpoq që të shmangte luftën dhe i pranoi të gjitha kushtet me përjashtim të pjesëmarrjes së zyrtarëve habsburgas në hetimin e vrasjes në Serbi. Pasi ultimatumit nuk u pranua plotësisht, me 28 korrik të atij viti filloi lufta. (Schevill, 2006, p. 395)

Shtetet ballkanike e panë luftën si një mundësi për të përmbushur qëllimet e tyre territoriale, të paplotësuara nga dy luftrat ballkanike dhe nuk i kushtuan asnjë rëndësi pasojave që sjellin luftrat. Shqetësimi i tyre i vetëm ishte se cili bllok do ta fitonte luftën. Dy blloqet e mëdha ndërluftuese, hynë në negociata me Greqinë, Bullgarinë, Rumaninë, ndërkohë në Shqipëri u futën trupa ushtarake të disa shteteve duke shkelur asnjëanësinë e deklaruar të saj.

Antanta formuloi një politikë me anë të së cilës ajo i jepte Serbisë territore në Shqipërinë e Veriut me mundësinë e një daljeje në det, si kompensim të territoreve që i jepeshin Bullgarisë në Maqedoni. Një rol të rëndësishëm në këto negociata i'u dha Greqisë, e cila sipas diplomatëve të Antantës, përbënte bërthamën e çdo skeme të suksesshme. Nëse sigurohej mbështetja greke, mbështetja bullgare do të vinte krejt natyrshëm (Gay, 2012, p. 124). Pavarësisht mendimit të diplomatëve të Antantës, arritja e marrëveshjeve me shtetet e Ballkanit rezultoi të ishte e vështirë. Edhe në kuadrin e një lufte botërore, këto

vende vazhdonin të udhëhiqeshin në politikën e tyre të jashtme nga pretendimet që kishin gjatë luftrave ballkanike. Tek shtetet ballkanike, marrja e territoreve të reja ishte parësore, ndërsa lëshimi ose shkëmbimi i territoreve nuk ishte një temë që mund të negociohej.

Qëllimi i qeverisë bullgare ishte rimarrja e Maqedonisë të cilën ajo nuk kishte mundur ta merrte gjatë luftrave ballkanike. Gjithashtu ajo donte të merrte edhe Dobrukhën e Jugut të cilën i'a kishte marrë Rumania gjatë këtyre luftrave. Për shkak të pozicionit gjeografik ajo kishte çfarë t'u ofronte të dy palëve. Po të bashkohej me Fuqitë e Qendrës, ata do të kishin një front solid që nga Gjermania deri në PO. Nga ana tjetër po të bashkohej me fuqitë e Antantës, Bullgaria mund të luante një rol të madh në fushatat në Dardanele dhe Galipoli. Në rastin e Bullgarisë aleatët ishin në pozita më të dobëta sepse pretendimet e Bullgarisë çënonin Serbinë e cila ishte aleatja e vetme e Antantës në këtë kohë në Ballkan. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006)

Si mbreti Ferdinand edhe qeveria bullgare kishin simpati ndaj fuqive të Bllokut Tripalësh. Njerëzit ishin të ndarë. Ata vërtet përkrahnin marrjen e Maqedonisë, por kishin në mendje tmerret e luftrave ballkanike dhe nuk ishin të gatshëm për një luftë të re. Aleatët ishin të gatshëm që t'i lëshonin Bullgarisë territoret në jug të vijës Kriva, Velesh, Ohër, por me kushtin që Serbia të merrte Bosnje-Hercegovinën. Ata ranë dakort që kufiri jugor i Bullgarisë të shtrihej në vijën Enos-Midia afër Stambollit. Por me këtë propozim nuk ra dakort qeveria e Serbisë e cila mbajti këtë qëndrim deri në shtator 1915. Në këtë kohë situata e Serbisë u përkeqësua por përsëri ra dakort të lëshonte vetëm gjysmën e territorit për të cilin flitej. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006, p. 266)

Ndërkohë, diplomacia e Fuqive Qëndrore nuk qëndronte duarkryq të cilët i ofruan Bullgarisë kufijtë e Traktatit të Shën Stefanit. Në këto kushte në shtator 1915 Bullgaria pranoi ofertën e shteteve gjermane. Në 14 tetor nisi një mësymje e madhe e ushtrive austro-gjermane kundër Serbisë ndërkohë që ajo u sulmua edhe nga Bullgaria. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006) Në të njëjtën kohë Antana zbarkoi në Selanik 4 divizione me shpresë për ti ardhur në ndihmë Serbisë, dhe u bënë përpjekje për të futur Greqinë në luftë, por pa sukses. Italianët zbarkuan në dhjetor rreth 30 mijë trupa ushtarake në Vlorë. Serbia nuk mund të rezistonte më, në fund të nëntorit ushtria serbe kaloi përmes Kosovës duke u tërhequr drejt portit të Durrësit.

Rumania ngurronte të hynte në luftë. Aty ekzistonte një ndarje midis palëve. Mbreti dhe një grup i vogël por me ndikim politikanësh përkrahin futjen e Rumanisë përkrah Fuqive Qëndrore. Ion. I. C. Brătianu, kryeministër i vendit, shumica e politikanëve dhe opinionit publik mbështesin Antantën. Qëllimi i përbashkët i rumunëve ishte bashkimi në një shtet, sepse pothuajse gjysma e rumunëve në vitin 1914 jetonin jashtë Rumanisë. Rumania kishte dy rajone të mëdha interesi, Transilvaninë dhe Besarabinë dhe dy më të vogla Bukovinën dhe Banatin. Tre nga këto krahina ishin nën kontrollin e Austro-Hungarisë dhe një nën kontrollin e Rusisë. Brătianu ishte i aktiv për të përfutur nga çdo mosmarrëveshje me aleatët për politikën e Ballkanit. (Spector, p. 55)

Kështu vetëm duke qëndruar neutrale Rumania në varësi të krahut që fitonte merrte një krahinë. Por në Rumani ekzistonte edhe frika se duke mos shpallur luftë kundrejt asnjërës palë, kur të vinte paqja Rumania mund të mbetej duarthatë. Kjo dilemë por sidomos edhe kundërsulmi rus i verës së 1916 i cili bombardoi pozicionet e ushtrisë austro-hungareze duke i detyruar të tërhiqeshin në rrëmujë, bëri që rumunët të futen në bisedime me Antantën dhe lidhën një marrëveshje sekrete e cila u siguronte gjithë Transilvaninë dhe një pjesë të Bukovinës që kishte në shumicë popullsi rumune. (Glenny, 2000, p. 341) Në këto kushte Rumania ra dakort që të lejonte furnizimet ruse drejt Serbisë nëpërmjet territorit të saj duke humbur kështu neutralitetin e saj.

Më 26 gusht 1916 vendi hyri në luftë kundër monarkisë së dyfishtë, por Rumania kishte pritur shumë. Gjermania në këtë kohë transferoi 15 divizione nga perëndimi drejt lindjes, duke mundur deri në fund të vitit ushtritë rumune ndërkohë që qeveria e saj u shpërgul në Moldavi. Fuqitë Qëndrore zotëronin 2/3 e vendit së bashku me burimet e naftës dhe furnizimet e drithit. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006, p. 269) Fundi i vitit 1916 e gjeti Antantën në pozitë të vështirë në të gjithë frontet. Rusia kishte humbur terren në lindje, Bullgaria në Ballkan ishte bashkuar me Fuqitë Qëndrore. Serbia ishte mundur dhe ofensiva në Galipoli kishte dështuar. Humbjet ushtarake e detyruan qeverinë rumune të nënshkruante një armëpushim me Fuqitë Qëndrore në dhjetor 1916, dhe pse në kundërshtim me këshillat e aleatëve që kërkonin që ushtria rumune të tërhiqej drejt Rusisë Jugore. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006)

Shteti i fundit ballkanik që u përfshi në LIB ishte Greqia. Kjo vonesë u shkaktua nga përplasjet e brendshme të cilat ishin shumë më të ashpra sesa në vendet e tjera ballkanike. Mbreti Kostandin ishte kunati i perandorit gjerman dhe nuk e fshihte dëshirën që të ishte krah e Fuqive Qëndrore. Kryeministri Eleftherios Venizelos, parashikoi se futja në luftë e Greqisë në anën e Antantës ishte një mundësi sepse me ndihmën e tyre pas fitores së luftës Greqia mund të përmbushte kërkesat e saj territoriale. (Gardikas-Katsiadakis, Helen Thanos Veremis, 2006) Kur më 7 shtator 1915, Bullgaria nënshkroi një marrëveshje me Fuqitë Qendrore dhe Venizelos e ashpërsoi më tej përballjen e tij me mbretin. Më 22 shtator ai denoncoi praktikën e Kostandinit i cili sipas Venizellos kishte injoruar parlamentin në çështjet e politikës së jashtme. Më 23 shtator Bullgaria mobilizoi forcat e saj dhe Venizellosi u përgjigj mos-gatishmërisë së mbretit për mobilizimin e Greqisë duke nxjerrë vetë një dekret. (Gardikas-Katsiadakis, Helen Thanos Veremis, 2006, p. 120) Aleatët e nxitën Greqinë përsëri të sulmonte Bullgarinë.

Përplasjet e brendshme politike nuk lejuan që Greqia të pozicionohej në krah të njërit prej blloqeve ndërluftuese deri në maj të vitit 1917 kur Londra dhe Parisi, vendosën të përfundojnë punën. Mbreti duhej të largohej, Venizelos duhet të ri-kthehej në Athinë dhe Greqia të bashkohej me Antantën. Qeveritë e Antantës i deleguan marrëdhëniet e tyre me Athinën tek një Komisioner i Lartë, administratori francez Charles Jonnart. Më 11 qershor ai i paraqiti një ultimatum Aleksandër Zaimis kryeministër i mbretit, duke kërkuar largimin e Kostandinit me pretekstin se ai kishte shkëlur Kushtetutën. Aleksandri, në moshën 23 vjeç, u lejua të merrte vendin e babait të tij. Të nesërmen Kostandini dhe familja e tij u larguan nga Athina për në Zvicër. (Dalby, 2011, p. 65) Atëherë edhe Venizellosi u kthye në Athinë. Në qershor të 1917 Greqia hyri në luftë në krah të aleatëve.

3. Vendimet e Konferencës së Paqes në Paris për Ballkanin dhe ndryshimet territoriale e politike në rajon

Në përfundim të LIB, vendet e Ballkanit aleate të Antantës u përgatitën për të korrur frytet e fitores, ato humbëse i varën shpresat tek 14 pikat e shpallura nga presidenti amerikan Woodrow Wilson dhe nga Konferenca e Paqes në Paris. Forcat gjermane në fund të muajit nëntor ishin larguar nga Rumania. Më 1 dhjetor mbreti Ferdinand u kthye si

triumfator në kryeqytetin e tij. (Hitchins, 2011, p. 84) Ai riemëroi në krye të qeverisë Brătianun i cili kishte pritshmëri të larta për kushtet e paqes dhe shpresonte të përmbushte ambicjet e Rumanisë, madje priste që të trajtohej si i barabartë nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Paqes. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006, p. 281)

Rumunët ishin aktive në Konferencën e Paqes. Brătianu mendonte ti vuloste në Paris fitoret e vendit të tij. I vetëdijshëm për vendin e tij në histori dhe për përgjegjësinë solemne të detyrës që mbante, Brătianu ishte i vendosur të merrte të gjitha territoret e premtuara në traktatet e 1916-ës. Ambicjet e tij ishin në kundërshtim me synimet e Fuqive të Mëdha për të vendosur një rend të ri ndërkombëtar dhe për të përmbushur qëllimet e tyre territoriale dhe strategjike. Brătianu gjithashtu u përball me rivalitetet historike dhe pretendimet territoriale të fqinjëve të Rumanisë, Hungarisë dhe Rosisë, Serbisë dhe Bullgarisë. (Hitchins, 2011, p. 86)

Si pasojë e disfatave të dy fuqive të mëdha, Austro-Hungarisë dhe Rosisë, për Rumaninë u krijua mundësia për t'u zgjeruar territorialisht, pasi ushtritë e saj gjendeshin në territoret që pretendonte dhe aleatët e Antantës ishin të ndarë në qëndrimet e tyre. Në Rusi kishte ardhur në fuqi një qeveri bolshevike të cilën fuqitë perëndimore e shihnin me mosbesim. Jo vetëm kaq, por edhe në Hungari qeveria e udhëhequr nga Bela Kuni kishte prirje të ngjashme me qeverinë ruse. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006)

Këto ngjarje avantazhonin Rumaninë e cila pretendonte të luante rolin e vendit që po mbronte Europën nga komunizmi. Pasi kishte aneksuar territoret që pretendonte, duke shfrytëzuar edhe situatën e vështirë dhe përplasjet e brendshme politike të Hungarisë, më 19 mars 1919 ushtria rumune hyri në Hungari dhe më 4 gusht pushtoi Budapestin. Si shpërblim rumunët kërkuan që Hungaria të dorëzonte gjysmën e flotës lumore dhe vagonave. (Rothschild, 2004, p. 153) Aleatët reaguesh për madje përfaqësuesi amerikan propozoi që flota aleate të dërgohej për të përmbajtur Rumaninë.

Bashkimi i Rumanisë me Besarabinë u sanksionua nga Fuqitë kryesore Aleate, Anglia, Franca, Italia, Japonia dhe Rumania, me anë të Traktatit të Parisit, të nënshkruar më 28 tetor 1920. Art. 1 përcaktonte që "*Palët e Larta Kontraktuese njohin sovranitetin e Rumanisë mbi territorin e Besarabisë*". (Ion M. Anghel, 2016, p. 46) Territori tjetër i pretenduar nga Rumania ishte Transilvania të cilën ajo e pushtoi. Kufiri

me Hungarisë, u vendos me Traktatin e Trianonit më 4 qershor 1920, i lidhur midis Fuqive Aleate dhe mike përfshirë Rumaninë nga njëra anë, dhe Hungarinë nga ana tjetër. Art. 27 i këtij Traktati përcaktonte: *"Hungaria heq dorë në favor të Rumanisë për të gjitha të drejtat dhe titujt e saj mbi tokat e ish-monarkisë Austro-Hungareze, të vendosur përtej kufijve të Hungarisë"*. (Ion M. Anghel, 2016, p. 42) Në Transilvani dhe në Besarabi popullsia lokale me anë të plebishiteve u shpreh në favor të bashkimit me Rumaninë.

Me një sipërfaqe prej 28.523 km² dhe një popullsi prej rreth një milion e gjysmë, në Banat, rumunët përbënin rreth 37.4% të popullsisë së përgjithshme, gjermanët 24.5%, serbët me 18% dhe hungarezët ishin 15.3%. Brătianu kërkoi Banatin bazuar në kritere etnike duke pretenduar se rumunët ishin kombësia më e madhe në rajon. Ai gjithashtu risolli në vëmendje traktatin sekret të gushtit 1916, traktat që e kishte futur Rumaninë në LIB në anën e Antantës. Traktati i kishte premtuar qeverisë rumune tërësinë e Banatit, Transilvaninë, Bukovinën. (Haynes, 2005, p. 100) Kërkesat e tij nuk u miratuan nga Konferenca pasi marrja komplet e Banatit rrezikonte Beogradin, nga një sulm rumun prandaj aleatët lejuan pushtimin e qarkut Torontal nga serbët, territor që përbënte dy të pestat e sipërfaqes së Banatit. Hungaria mori një pjesë të vogël të Banatit, ndërsa tre të pestat iu dhanë Rumanisë. Ndarja e Banatit la rreth 75,000 rumunë në Mbretërinë SKS dhe rreth 65,000 serbë u lanë në Rumuni. (Haynes, 2005, p. 101) Zgjidhja e ndarjes nuk u aplikua në Transilvani me Hungarinë ku Traktati i Trianonit la gati 1.3 milion hungarezë në Rumani.

Politikanët serbë i'u futën punës për krijimin e "Serbisë së Madhe" ku u kuptua se fitorja ishte në anën e tyre. Më 20 korrik të 1917 u nënshkrua Deklarata e Korfuzit midis përfaqësuesit të "Komitetit Jugosllav" Ante Trumbić, dhe kryeministrit të qeverisë mbretërore serbe Nikolla Pashiç, e cila përcaktonte bashkimin e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve. Në këtë deklaratë theksohej se shteti i ardhshëm do të ishte një monarki kushtetuese parlamentare me në krye dinastinë e Karagjorgjeviçëve dhe u quajt "Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve" (më tej SKS). (Pavlovic, 2017, p. 1036)

Në Zagreb, Këshilli Kombëtar i kroatëve, serbëve dhe sllovenëve deklaroi pavarësinë nga Monarkia e Habsburgëve dhe krijimin e "Shtetit të Sllovenëve, Kroatëve dhe Serbëve". Hapi tjetër nuk ishte i qartë, nëse ata do të rrinin të pavaruar apo do ti

bashkangjiteshin Serbisë. Në përbërjen e shtetit, u futën përveç Kroacisë e Sllovenisë edhe Bosnjë-Hercegovina. Ante Trumbici dhe përkrahësit e tij parapëlqenin një federatë, por një numër i madh kroatësh kërkonin pavarësinë e plotë. (Macmillan, 2006, p. 148) Dallimet midis qeverisë serbe dhe Komitetit Jugosllav i'u komunikuan fillimisht francezëve dhe më pas qeverisë britanike, por aleatët nxitën Trumbicin dhe Pashiqin, se ata të dy duhej të bënin një marrëveshje. (Pavlovic, 2017, p. 1039)

Në terren ngjarjet po ecnin me shpejtësi. Trupat serbe pushtuan Malin e Zi dhe një kuvend i zgjedhur votoi në favor të bashkimit me Serbinë. Edhe në Zagreb, Këshillin Kombëtar e zuri paniku, sepse mungonte rregulli dhe trupat italiane po pushtonin portet kryesore. Më 25 nëntor Këshilli vendosi ti kërkonte Serbisë bashkimin. (Macmillan, 2006, p. 149) Si pasojë, më 1 dhjetor 1918, në Beograd, në prani të përfaqësuesve të Mbretërisë së Serbisë, të “Veçes Qendrore Popullore” të Zagrebit, të Skupshtinave të Malit të Zi dhe të Vojvodinës, u shpall formimi i “Mbretërisë i SKS”. Në përbërjen e tij u futën përveç Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Bosnje-Hercegovinës edhe Mali Zi, Vojvodina, Maqedonia e Kosova. (Pavlovic, 2017, p. 1040)

Vendimi i 1 dhjetori 1918 për të zgjedhur një bashkim të pakushtëzuar, u bë kryesisht nga frika se statusi i përkohshëm i pranisë italiane në Adriatik mund të shndërrohej në të përhershëm. E vetmja mënyra për ta parandaluar këtë, ishte pjesëmarrja në Konferencën e Paqes, me një delegacion të bashkuar. Sidoqoftë, gjatë Konferencës së Paqes, delegacionet nga të dy pjesët e mbretërisë së re duhej të përdornin të gjithë kapacitetet e tyre në qëllim për të mbrojtur interesat territoriale të sllovenëve, kroatëve dhe serbëve, që dikur jetonin në të Austro-Hungari. (Pavlovic, 2017, p. 1046) Më 20 dhjetor u formua qeveria e parë e shtetit SKS, me liderin e Partisë Radikale Serbe S. Protic, si kryeministër dhe zëvendës A. Koroshec dhe ministër të punëve të jashtme Trumbic. Shteti SKS u bë shteti më madh ballkanik pas LIB. Pavarësisht zgjerimit të madh territorial, orekset e klasës politike serbe e cila dominonte në këtë shtet nuk u shuan, por ato vazhduan një politikë agresive në drejtim të fqinjëve sidomos të Shqipërisë.

Bullgaria ishte aleate e fuqive që humbën luftën. Në shtator 1918 ushtria e saj kapitulloi. Fqinjët e saj triumfatorë, u përpoqën ta dobësonin sërish atë. Rumania kishte trupa në kufirin verior dhe po

përgatitej për të lëvizur në jug. Greqia po grumbullonte trupa në kufirin jugor të Bullgarisë dhe po ankohej për krimet bullgare. Serbia po tregohej më e matur por qëllimet e saj ishin më të mëdha. Aty kishte njerëz që ushqenin idenë e një bashkimi me Bullgarinë. (Macmillan, 2006, p. 171) Nga ana e tyre bullgarët e pritën me optimizëm, Konferencën e Paqes që po mbahej në Paris. Në fakt Bullgaria u thirr vetëm për të firmosur atë që kishin vendosur Fuqitë Aleate.

Bullgarët u thirrën në 19 tetor 1919 në Paris për të dëgjuar kushtet e traktatit të cilat ishin më këqija sesa ata kishin pritur. Ata kërkuan dhjetë ditë, gjatë të cilave përgatitën përgjigjen e tyre. Ankesat e tyre u dëgjuan në 24 tetor. Pika kryesore e mbrojtjes ishte që Bullgaria kishte ndryshuar dhe tani ishte një vend paqësor dhe demokratik, por kjo pati një efekt të vogël. Disa ndryshime u bënë në klauzolat financiare dhe aleatët pranuan argumentin bullgar se disa nga dispozitat në lidhje me pakicat ishin përfshirë tashmë në kushtetutën bullgare. Sidoqoftë, në përcaktimet territoriale dhe ushtarake, aleatët nuk ndryshuan qëndrim. Delegacioni u kthye në Sofje, ku kryeministri Georgi Todorov njoftoi se nuk mund të vendoste emrin e tij në një traktat të tillë dhe dha dorëheqjen si kreu i delegacionit bullgar. (Crampton, 2019)

Mbreti i ri, si edhe shumë të tjerë, kuptuan se Bullgaria nuk ishte në gjendje të rezistonte dhe se nuk kishte alternativë përveç të pranimit kushtet. Aleksandar Stamboliski mori vendimin e guximshëm të kthehej në Paris dhe të nënshkruante traktatin për t'i dhënë fund asaj lufte që ai e kishte kundërshtuar dhe ishte burgosur për këtë veprim. (Crampton, 2019, p. 60) Me Traktatin e Nejit, Bullgaria kishte humbur të drejtën jo vetëm mbi tokat e pushtuara gjatë luftës por edhe disa provinca që ajo i zotëronte në peridhën e para luftës. Provincat Caribrod dhe Strumnica ju dhanë "Mbretërisë, SKS", pjesët jugore të fushës së Dobruhdës, Rumanisë, Traka Perëndimore kaloi nën kontrollin e Greqisë. Bullgaria në LIB humbi 8 % (10.750 km²) të territorit të para luftës. Përveç kësaj në marrëveshje ajo kishte pranuar që të paguante reparacione në vlerë 2,25 miliard franga ari. (<https://www.britannica.com/place/Bulgaria/World-War-I>)

Në përfundim të LIB Shqipëria vazhdonte të ishte e pushtuar. Trupat austro-hungareze u larguan, por vendin e tyre e zunë trupat italiane. Në rajonin e Korçës vazhdonin të qëndronin trupat franceze, ndërsa në Shkodër një forcë e përbashkët e trupave aleate. E ardhmja e

Shqipërisë ishte e paqartë. Faktori politik shqiptar ishte i përçarë, ndërkohë që princ Vidi e kishte humbur mbështetjen brenda dhe jashtë vendit. Lufta kishte patur pasoja të mëdha. Së pari në arenën ndërkombëtare, gjashtë Fuqitë e Mëdha, krijueset dhe garantueset e Shqipërisë nuk egzistonin më si në formatin e paraluftës. Disa shtete ishin mundur, të tjera kishin ndyshuar qëndrimet e tyre në lidhje me Shqipërinë. Së dyti gjatë periudhës së luftës ishte nënshkruar Trakati i Fshtëtë i Londrës i cili copëtonte Shqipërinë.

Ndërkohë gjatë luftës në Shqipëri ndodhën 3 ngjarje të rëndësishme a) shpallja e vetqeverimit në Korçë, 2) proklamata e 23 janarit 1917 nga autoritetet austro-hungareze në Shqipëri 3) proklamaten e lëshuar nga gjenerali italian Ferrero. Të treja këto ngjarje ishin shprehje e dëshirave të popullsisë lokale që kishin detyruar autoritet ushtarake të ndërmerrnin këto hapa.

Për të mbrojtur shtetin e tyre shqiptarët u përballën me kërkesat e Italisë, e cila ishte shndërruar nga mbrojtëse e shtetit shqiptar, në një shtet që rrezikonte pavarësinë e Shqipërisë dhe frenuan ambicjet e Greqisë dhe shtetit të ri SKS. Për t'ju përgjigjur nevojave të vendit në janar 1919 në Durrës u mbledh një Kongres i cili zgjodhi një qeveri të përkohshme. Kongresi ngriti një delegacion i cili do të përfaqësonte Shqipërinë në Konferencën e Parisit. Delegacioni shqiptar i përbërë nga Turhan pashë Përmeti, Mehmet Konica, Mithat Frashëri dhe Mihal Turtulli paraqiti pretendimet në Konferencën e Parisit në një varg memorandumesh të cilat i bënë me dije konferencës, se shqiptarët përkrahin parimin e vetvendosjes dhe kërkonin që Shqipërisë ti riktheheshin territoret që i ishin marrë nga vendimet e vitit 1913. (Historisë, 2016, p. 421)

Konferenca nuk i mori parasysh kërkesat shqiptare, por nisi të shqyrtonte propozimet greke. Çështja shqiptare kaloi për shqyrtim tek Komisioni për Çështjet Greke, që ishte krijuar në shkurt 1919 pranë Konferencës së Paqes, përbërë nga Franca, Anglia, ShBA dhe Italia. Delegacioni grek paraqiti përpara Këshillit Suprem të Konferencës së Paqes pretendimet territoriale për Jugun e Shqipërisë, në një rajon ku banonin sipas tij 120 mijë greke dhe 80 mijë shqiptarë. U argumentua gjithashtu se ishte e drejtë që pakica shqiptare të përfshihej në Greqi për shkak të qytetërimit të saj epror. (Swire, 2005 , p. 241)

Për çështjen shqiptare Fuqitë e Mëdha ishin të ndara. Italia ishte që kufijtë e jugut të mbeteshin ata të vitit 1913, Anglia dhe Franca ishin

për dhënien e Korçës dhe Gjirokastrës Greqisë, ndërsa ShBA e quante të mjaftueshme që Italisë ti jepej Vlora, Gjirokastra ti jepej Greqisë, kurse Korça ti lihej Shqipërisë. Për shkak të mosmarrëveshjeve çështja e Shqipërisë mbeti e hapur dhe u diskutua në kuadrin e çështjes së Adriatikut. (Duka, 2007, p. 103)

Në Itali kabineti i Vittorio Orlandos dha dorëheqjen dhe u zëvendësua nga kabineti i Francesco Nittit i cili gjykonte se çështja e Adriatikut duhet të merrte zgjidhje të shpejtë. Ai e ndryshoi politikën italiane për jugun e Shqipërisë duke përkrahur synimet e Greqisë për pretendimet italiane gjetkë. Në këtë frymë u nënshkrua marrëveshja Venizelos-Titoni. (Joseph, 2011) Marrëveshja ngjalli pakënaqësi tek fuqitë e tjera. Franca refuzoi të linte Korçën derisa të arrihej një marrëveshje e përgjithshme. Anglezët u irrituan nga prania kaq e madhe e italianëve në Adriatik, ndërkohë që ata nuk ishin pjesë e kësaj marrëveshjeje. Goditjen vendimtare kësaj marrëveshjeje i'u dha nga presidenti Wilson i cili deklaroi se nuk mund të bënte një padrejtësi kundrejt Shqipërisë. (Macmillan, 2006, p. 422) Përballë mosdakortësisë nga ana e Fuqive të Mëdha çështja shqiptare u shty.

Në këtë situatë mes shqiptarëve filluan mosmarrëveshjet. Përfaqësuesit e diasporës i'u kundërvunë, italoofilëve të qeverisë së Durrësit. Qëndrimi për një shtet kujdestar ndaj Shqipërisë përçau edhe delegacionin e Durrësit. Mihal Turtulli dhe Mehmet Konica kishin kritika për mënyrën sesi delegacioni shqiptar po e trajtonte çështjen e Italisë. Delegacioni nuk ishte shprehur qartë për zbrazjen e Vlorës nga ana e Italisë dhe një shtet mbrojtës i Shqipërisë nuk mund të shkëpuste pjesë të vendit. (Puto, 2003, pp. 306-307)

Ngjarjet në Shqipëri morën një tjetër zhvillim si pasojë e lëvizjeve të brendshme politike-ushtarake. Kongresi i Lushnjës i mbajtur në janar 1920, rrëzoi qeverinë e Durrësit. Qeveria e re e dale nga ky kongres tregua mjaft aktive. Ajo nisi bisedimet me qeverinë e Romës për çështjen e Vlorës, kurse fshehurazi përkrahu kryengritjen anti-italiane që nisi në Vlorë. Kryengritësit shqiptarë luftuan më trimëri dhe shfrytëzuan si gjendjen e vështirë të trupave italiane në Shqipëri dhe situatën e brendshme në Itali ku kishin shpërthyer greva të shumta, për të detyruar qeverinë italiane, që më 20 gusht 1920 të nënshkruante protokollin paraprak, ku Italia respektonte integritetin territorial të Shqipërisë. (Duka, 2007, pp. 110-118)

Pas zgjidhjes së problemit italian, përpjekjet e qeverisë shqiptare u përqëndruan në aderimin e saj në Lidhjen e Kombeve. Mbështetja e Britanisë së Madhe e zgjidhi çështjen në favor të palës shqiptare. Britania pas propozimit të dy përfaqësuesve të zotërimeve të saj, ato të Kanadasë dhe Afrikës së Jugut bëri që Shqipëria të pranohej në Lidhjen e Kombeve. (Puto, 2003, p. 345) Ndonëse Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve qeveria e saj nuk u njoh.

Çështjet kufitare me shtetin SKS dhe Greqinë morën vëmendjen e qeverisë shqiptare. Do të ishte Konferenca e Ambasadorëve e cila me vendimin e e 9 nëntorit 1921 shpallte njohjen e qeverisë shqiptare si një qeveri e një shteti sovran dhe të pavarur. Vendimi i 9 nëntorit gjithashtu përcaktonte krijimin e një komisioni për caktimin e kufirit jugosllavo-shqiptar. Përsa i përkiste kufirit me Greqinë, atë kishte caktuar Konferenca e Ambasadorëve në Londër e vitit 1913 me anë të komisionit për kufijte e jugut. (Kotta, 2016, p. 72) Komisioni Ndërkombëtar Kufirit me gjithë divergjencat që kishte arriti të përfundonte punën. Pasi zhvilloi takimin e fundit më 10 dhjetor 1913 në Gjirokastër ai u largua në drejtim të Firences ku u hartua protokoll i Firences i cili u firmos nga gjashtë anëtarët. Vija kufitare e Firences është thujse vija e kufirit shqiptaro-grek. (Dushku, 2012, p. 217)

4. Ballkani, aty ku lufta vazhdon. Lufta greko-turke e viteve 1919-1922

Lufta e Parë Botërore përfundoi më 11 nëntor 1918, por në Ballkan, Greqia në vitin 1919 filloi një konflikt të ri. Greqia hyri në LIB pa marrëveshje specifike për kërkesat e saj. Vetëm Traktati i Fshehtë i Londrës parashikonte që Greqia të zgjerohej territorialisht në jug të Shqipërisë. Pavarësisht kësaj qeveria greke dhe Venizelosi kishin pretendime të mëdha. Ai shfrytëzoi të gjitha historinë, fenë, gjuhën dhe sigurisht vetvendosjen. Greqia duhej të kishte pjesën jugore të Shqipërisë, së paku Trakën Perëndimore, disa ishuj dhe një pjesë të mirë të Azisë së Vogël. (Macmillan, 2006, pp. 410-411) Për të arritur këto qëllime duhej fituar përkrahja e Fuqive të Mëdha, Francës, Britanisë dhe SHBA. Në fakt edhe situata gjeopolitike ishte në favor të saj.

Kur Venizelosi e paraqiti çështjen greke tek Këshilli Suprem, ai ishte i bindur që Britania do të qëndronte përkrah Greqisë. Po jo vetëm kaq, sepse ai mendonte të mbështetej edhe tek Franca, tashmë

që trupat greke po luftonin në krah të francezëve kundër bolshevikëve. Amerikanët ishin dashamirës ndërsa merakut i tij më i madh ishte Italia. (Macmillan, 2006, p. 414). Konferenca e Parisit ishte arritja kryesore e diplomacisë së Venizelos, ku ai përdori të gjitha mjetet diplomatike për të arritur qëllimet për Greqinë. Ai ishte mjeshtër i argumenteve për të mbështetur pretendimet greke. Miqësia e tij me Lloyd George i dha një avantazh në bisedimet diplomatike. (Smith, 2006, p. 161)

Për pretendimet bullgare Venizelosi nuk hasi në vështirësi të mëdha. Fuqitë e Mëdha i'a plotësuan kërkesat, duke i'u imponuar Bullgarisë edhe për faktin se ajo ishte shtet i mundur. Me Shqipërinë ndryshonte puna, sepse Shqipëria në fillim të konfliktit kishte shpallur asnjëanësinë e saj dhe aty ndërthureshin interesat e disa shteteve fituese të luftës

Më 10 gusht 1920 midis Fuqive Aleate e Shoqe dhe PO u nënshkrua me Traktati i Sevres. Sipas traktatit, Greqia do të merrte Trakën Lindore. Përveç kësaj ajo do të administronte Smirnën dhe rrethinat e saj për 5 vjet. Pas kësaj periudhe ishte parashikuar që të mbahej një plebishit popullor. Greqisë iu dhanë edhe dy ishujt strategjikë të Tonedos dhe Imbros, ndërkohë që ngushticat u ndërkombëtarizuan. (<https://www.britannica.com/event/Treaty-of-Sevres>) Greqia nga ana e saj angazhohej të siguronte mbrojtjen e jetës dhe lirive të të gjithë banorëve të saj, pa dallim të vendlindjes, kombësisë, gjuhës, racës apo fesë. Të gjithë banorët e Greqisë do të lejoheshin të ushtronin lirisht publikisht e privatisht fenë e besimin. Greqia pranonte dhe deklaronte se ata do të ishin shtetas grekë pa kërkuar ndonjë formalitet individët e kombësive bullgare, turke ose shqiptare të cilët ishin rezidentë në territoret që i ishin dhënë Greqisë prej traktateve ndërkombëtare qysh prej 1 janarit të vitit 1913. (Smith, 2006) Ky moment përbënte kulmin e triumfit të Megali Idesë dhe realizimin e ëndrrës së vjetër greke.

Kjo ishte vetëm një pjesë e ambicjeve të Venizelosit. I përkrahur nga aleatët, veçanërisht kryeministri britanik George, trupat greke zbankuan në Smirna më 15 maj 1919. Venizelos në Athinë, e përshkroi çështjen si një zgjedhje e ndërmarrë sipas kushteve të traktatit dhe të pretendimeve greke dhe si përgjigje ndaj presionit të qarqeve ushtarake franceze, italiane dhe britanike. Prandaj, në këtë pikë kritike për historinë e kombit, ai duhej merrte vendimin që trupat greke të ishin në krah të forcave britanike në Turqi. Ai kishte shtuar se nëse edhe kjo

nuk do t'i detyronte turqit të nënshkruanin traktatin, ai do të merrte përsipër të rriste forcën e ushtrisë greke, forca të cilat së bashku me trupat britanike do ti impononin traktatin Turqisë. (Smith, 2006, p. 164)

Ata pushtuan qytetin dhe përparuan në brendësi të vendit dhe morën kontrollin e pjesës perëndimore dhe veriperëndimore të Anadollit. Britania inukrajoj Greqinë që të përparonte drejt brendësisë së territoreve turke, me qëllim që të bindte sulltanin të heshte, por edhe të ushtronte presion mbi Ataturkun dhe pasuesit e tij. Forcat greke pushtuan Bursën dhe përparuan në brendësi të rrafshnaltës së Anadollit. Ata gjithashtu pushtuan Trakinë Lindore dhe Adrianopojën. Ushtria greke ishte nën komandën e Venizelos dhe ai shpresonte të nxirrte përfitime territoriale nëse Turqia nuk i pranonte kushtet e traktatit. Traktati i Sevres u nënshkrua në 10 gusht por asnjëherë nuk u ratifikua apo zbatua. (Smith, 2006) Sulltani pranoi kushtet e paqes duke sjellë përmbyshjen e qeverisë osmane.

Në krye të lëvizjes revolucionare ishte një gjeneral i quajtur Qemal Ataturk. Ai kishte treguar aftësi të mëdha në luftë kundër rusëve dhe në fushatën e Dardaneleve. Pas luftës ai filloi të organizojë një rezistencë kundër sulltanit dhe fuqive aleate. Në fillim ai nuk gjeti mbështetje në popullsinë turke e cila vazhdonte të mbështeste sulltanin-kalif. Por situata ndryshoi kur grekët u futën në Traki dhe sidomos kur zbarkuan në Smirne. Trupat greke filluan të avancojnë në brendësi të territoreve turke. Si pasojë Ataturku gjatë vitit 1919 e zhvendosi qendrën në Ankara, por ngaqë sulltani kishte akoma mbështetje ai nuk i doli menjëherë kundër. (Jelavich, Charles e Barbara, 2006) Pozicioni i Greqisë në këto momente dukej mjaft i favorshëm. Kundërshtarët e saj në Ballkan, Bullgaria dhe PO ishin mundur. Në gusht të vitit 1920 forcat greke filluan një fushatë kundër turqve të cilët u tërhoqën në thellësi të Anadollit. Trupat greke hynë në brendësi të Anadollit në një truall të panjohur dhe armiqësor. (Macmillan, 2006, p. 511)

Pikërisht në këtë moment filluan problemet për Venizelosin. Ai i ishte drejtuar mbështetjes së huaj për të fituar mbi kundërshtarët tij politikë. Politika e mbretit mund të kishte qenë gabim, por Venizellos nuk kishte pse të lidhej me fuqitë e huaja për ta detyruar atë të hynte në luftë dhe nuk duhet ta kishte marrë pushtetin duke shfrytëzuar forcat aleate. Arritjet e Venizellosit dhe politika e tij pro-Antantës nuk e zvogëloi kundërshtimin ndaj precedentit që ai kishte vendosur për sovranitetin e Greqisë nga Fuqitë e Mëdha. Arritjet territoriale të

Greqisë sipas Traktatit të Sevres vlerësoheshin si e drejtë e tyre, në bazë të parimit të kombësisë. (Toynbee, 1922, p. 109).

Rikthimi në fuqi të mbretit Konstandin I, i njohur për qëndrimet e tij progjermane bëri që Anglia dhe Franca të rishikonin mbështetjen e mëtejshme të planeve ekspansioniste territoriale greke në Azinë e Vogël. (Milo, 2013, p. 500) Kthimi i tij nuk do të thoshte braktisje e politikës së Venizelosit në Turqi. Ndonëse rojalistët e kishin kritikuar këtë fushatë edhe ata ishin përfshirë në valën e entuziazmit të realizimit të Megali Idesë, por më 24 gusht 1921 marshimi i trupave greke u ndal përgjatë bregut lindor të lumit Sakaria në Anadollin Qëndror. Për dy javë trupat greke sulmuan pozicionet e fortifikuara turke në një betejë të ashpër ku të dyja palët humbën gjysmën e trupave dhe si pasojë e rezistencës më 16 shtator trupat greke filluan të tërhiqen. Fitorja ndaj grekëve bëri që pushteti tashmë të ishte në duart e Ataturkut dhe jo në Kostandinopojë.

Në këtë situatë, Ataturku gjeti një aleat të vlefshëm Bashkimin Sovjetik. Afrimi i tij me regjimit bolshevik tregoi nevojën e Turqisë për mbështetje ndërkombëtare ushtarake dhe diplomatike. Përfundimi i një serie marrëveshjesh dypalëshe, zgjidhën çështjen e mprehtë të kufijve të Kaukazit. Suksesi i tij diplomatik vazhdoi edhe më tej kur Franca evakuoit trupat e saj nga territoret turke në këmbim të favoreve ekonomike. Në tetor të vitit 1921 Italia, Franca, BS kishin bënë marrëveshje me Qemal Ataturkun dhe jo me sulltanin që vazhdonin ta mbështesnin vetëm Britania dhe Greqia. (Klapsis, p. 85) Trupat britanike ishin stacionuar në Stamboll prandaj Ataturku duhet vetëm të përzinte ushtrinë greke nga Anadoli.

Në gusht të vitit 1922 udhëheqësi turk nisi një fushatë kundër trupave greke të cilat nuk qenë në gjendje të përballonin sulmin. Në 9 shtator pasi kishin dërrmuar trupat greke, ushtria turke hyri në Smirna. Pas kësaj vëmendja u kthye në Trakën Lindore. Si shefat e tyre në Londër, Paris, Romë edhe diplomatët në Smirne i braktisën grekët. Me dështimin e aleatëve për të imponuar vendimet e tyre Stambolli dhe ngushticat u kthyen nën kontrollin turk. (Macmillan, 2006, p. 512) Më 1 nëntor 1922 asambleja turke deklaroi se sulltanati pushonte së ekzistuari. Sulltan Muhamedi VI u largua me një anije britanike. Traktati i Sevres pushoi u hodh poshtë, një marrëveshje e re do të bëhej me turqit që tashmë përfaqësonin një kauzë fitimtare.

Bisedimet filluan në nëntor 1922 dhe vazhduan deri më 23

korrik 1923, kur u nënshkrua Traktati i Lozanës. Sipas këtij traktati turqit mbanin krejt Anadollin, Trakinë Lindore, ngushticat si dhe ishujt e Tenedos dhe Imbros. Nuk u përcaktuan dëmshpërblime dhe kapitullimi i Perandorisë Osmane u hoq. Me gjithë përpjekjet turke dhe sovjetike, Britania siguroi një zgjidhje optimale për interesat e veta. (Mantran, 2004, p. 572) Ngushticat do të çmilitarizoheshin dhe do të ishin të hapura për të gjitha anijet kur Turqia nuk ishte në luftë.

Përfundime

Luftrat ballkanike ishin fillimi i një periudhe përplasjesh e konfliktesh në Ballkan që zgjatën 10 vjet. Dëshirat për zgjerim territorial shkaktuan vdekje dhe shkatërime në Ballkan, tragjedi të cilat u përligjën me fitoret territoriale. Ambicjet e politikanëve ballkanas shpesh iu kundërvunë këshillave të diplomatëve europiane, realpolitika përcaktonte marrëdhëniet midis vendeve ballkanike.

Diplomacia e Fuqive të Mëdha shfrytëzoi ambicjet e vendeve ballkanike gjatë Luftës së Parë Botërore duke lidhur me këto shtete marrëveshje të fshehta që sollën edhe më shumë vështirësi në periudhën e pas luftës. Një nga traktatet me problematikë rezultoi të ishte Traktati i Fshehtë të Londrës. Aty ishin të përfshira tre Fuqi të Mëdha dhe 4 shtete ballkanike. Secili kërkonte të realizonte atë që i ishte premtuar. Bullgaria u rreshtua përkrah Fuqive Qëndrore, ndërsa, Rumania, Serbia, Mali i Zi dhe Greqia përkrah Antantës. Asnjëanësia e Shqipërisë nuk u respektua, territori i saj u shkel e u pushtua nga të gjithë. Ballkani gjatë kësaj lufte u shndërrua në teatër betejash e operacionesh.

Në fund të Luftës së Parë Botërore vendet ballkanike ishin më larg njëra-tjetrës se në fillim të konfliktit sepse politikanët e Ballkanit gjatë 4 luftrave u udhëhoqën nga parimet e vjetra të përfitimeve territoriale dhe në asnjë moment nuk pati përpjekje të sinqerta për bashkëpunim midis vendeve të Ballkanit.

Fundi i Luftës së Parë Botërore solli ndryshime të mëdha në hartën politike të Ballkanit. Shpërbërja e monarkisë shumëkombëshe Austro-Hungareze, solli zgjerimin e Serbisë dhe Rumanisë, kurse dalja e Rusisë nga lufta i la dorë të lirë Rumanisë për të aneksuar Besarabinë. Kësisoj Rumania dhe Serbia përfituan shumë në këtë kohë ndryshimesh të mëdha, por me çmimin se tani ato ishin shtete multinacionale.

Përfundimi i luftës si në mbarë botën u prit me gëzim në Ballkan, por vendimet e Konferencës së Parisit nuk u morën mbi bazën e 14 pikave të Presidentit Willson, por mbi bazën e interesave të Fuqive të Mëdha. Në këto vendime nuk dominoi e drejta për vetvendosje por imponimi i më të fortit gjë që nuk lejoi krijimin e një rajoni të qetë.

Humbja e Perandorisë Osmane, në Greqi krijoi iluzione se ishte koha për të përmbushur Megali Idenë. Greqia dhe Turqia vazhduan luftën deri në vitin 1922 duke i shkaktuar njëra-tjetrës humbje njerëzore, ushtarake, ekonomike pasoja të mëdha për të dy vendet.

Bibliografi

Akademia e studimeve Albanologjike. (2016) Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX.

Anghel, Ion M. (2016) "The Borders of Greater Romania", Annals of the Academy of Romanian Scientists, Series on History and Archaeology, ISSN 2067-5682 Volume 8, Number 1/2016 <http://aos.ro/wp-content/anale/IVol8Nr1Art.2>

Ann Haynes, Rebecca. (2005) "A new Greater Romania? Romanian claims to the Serbian Banat in 1941", Central Europe, Vol. 3, No. 2, November 2005, Bakic, Dragan. Nikola Pasic and the Foreign Policy of the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes, 1919–1926, Institute for Balkan Studies Serbian Academy of Sciences and Arts Belgrade, DOI: 10.2298/BALC1647285B,

Bashkurti, Lisen. (2014) Nga Koncerti i Vjenës në Funeral Botëror. Tiranë: Global Challenge

Crampton, Richard J. (2011) Aleksandur Stamboliiski. Bulgaria: The Peace Conferences of 1919-23 and Their Aftermath (Makers of the Modern World). London: Haus Publishing Ltd,

Dalby, Andrew. (2011) Eleftherios Venizelos. Greece: The Peace Conferences of 1919-23 and their Aftermath (Makers of the Modern World). London: Haus Publishing Ltd

Duka, Valentina. (2007) Histori e Shqipërisë 1912-2000. Tiranë: Shblu

Dushku, Ledia. (2012) Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia 1912-1914. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Historisë

Frashëri, Kristo. (1997) Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881. Tiranë: Toena

Gay, Nicola. (2012) Lindja e Shqipërisë. Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare. Tiranë: Pegi

Glenny, Misha. (2000) Historia e Ballkanit 1804-1999. Tiranë: Toena

Hitchins, Keith. (2011) Ionel Bratianu. Romania: The Peace Conferences of 1919-23 and Their Aftermath (Makers of the Modern World). London: Haus

Publishing Ltd 70

<https://www.britannica.com/place/Bulgaria/World-War-I>

Jelavich, Charles e Barbara. (2006) Themelimi i shteteve kombëtare në Ballkanit 1804-1920

Joseph, Swire. (2005) Shqipëria ngritja e një mbretërie, Tiranë: Dituria

Klapisis, Antonis. (2002) "Turkey's search for a në foreign policy, 1923-1925: The View of Greek Diplomacy":

[www.imxa.gr/files/bsfiles/46/BalkanStudies\(5\)%20Klapisis%20final%2002](http://www.imxa.gr/files/bsfiles/46/BalkanStudies(5)%20Klapisis%20final%2002)

Kotta, Nuçi. (2016) Shqipëria dhe çështja e kufijve shqiptaro grek. Tiranë: Bota shqiptare

Lory, Benard. (2007) Europa Ballkanike, nga 1945 në Ditët Tona. Tiranë: Dituria

Macmillan, Margaret. (2006) Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën. Tiranë: Plejad

Michael.Ll Smith, Venizelos' Diplomacy, 1910–23, From Balkan Alliance to Greek-Turkish Settlement

Pavlovic, Vojislav. (2017) The Treaty Of London And The Creation Of Yugoslavia, Acta Histriae, Doi 10.19233/Ah.2017.48),

<https://www.britannica.com/event/Treaty-of-Sevres>

Puto, Arben. (2003) Historia diplomatike e çështjes shqiptare. Tiranë: albin

Rothschild, Joseph. (2004) Europa Lindore Qendore midis dy luftrave botërore. Tiranë: Dituria

Schevill, Ferdinand. (2006) Ballkani Historia dhe Qytetërimi. Tiranë: Uegen

Schurman, Jacob Gould. (2006) Luftrat Ballkanike 1912-1913. Tiranë: Uegen,

Sherman D. Spector, (1962) Romania at the Paris Peace Conference, A study of the diplomacy of Ioan Bratuaun New York: Bookman associates.

<http://aos.ro/editura/analeleaosr/annals-on-history>

Smith, Michael Llewellyn. (2006) Venizelos' Diplomacy, 1910–23: From Balkan Alliance to Greek-Turkish Settlement, Edinburgh University

<https://doi.org/10.1515/9780748627004-01>

Toynbee, Arnold J. (1922) The Western Question in Greece and Turkey, A Study in the Contact of Civilisations, <http://louisville.edu/a-s/history/turks/WesternQuestion>

Veremis, Thanos and Gardikas-Katsiadakis, Helen. (2006) Eleftherios Venizelos. Protagonist in politics 1912-1920. Edinburgh: Edinburgh

University Press